



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:021510

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05874273

KPPP.nr.130/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.P.SH. “Bageri”, me NUI: 810644197, me seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fitim Shabani, avokat nga Ferizaj, kundër debitorit “BSB Outlet-London” SH.P.K., me NUI: 810175572, me seli në Podujevë, rr. “Skenderbeu” nr.280, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.394/2023 të datës 20.11.2023 të Përmbartuesit Privat Mubarak Shumolli, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “BSB Outlet-London” SH.P.K., ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.394/2023 i datës 20.11.2023 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Mubarak Shumolli dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Mubarak Shumolli, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.P.SH. “Bageri”, ka caktuar urdhrin P.nr.394/2023 të datës 20.11.2023, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. 47 të datës 05.08.2022; Faturës Nr. 88A të datës 01.10.2022 dhe Faturës Nr. 106 të datës 22.11.2022, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri t’ia paguaj kreditorit tërësisht borxhin në shumën prej 55,000.00 €, me kamatë ligjore prej 8% e deri në pagesën e plotë, si dhe shpenzimet e përmbartimit, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm, me bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorit dhe bartjen nga llogaritë e debitorit në llogarinë e kreditorit, ose të

regjistrohen, konfiskohen dhe shitet pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme e debitorit, derisa të kryhet obligimi në tërësi.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor dhe ka deklaruar se obligimi sipas propozimit nuk ekziston, ngase verbalisht kreditori është njoftuar shumë më herët për qëllimin e ndërprerjes së kontratës dhe se palët janë pajtuar verbalisht për ndërprerjen e kontratës, ku kreditori ka kërkuar të bëhet pagesat prej 5,000.00 €, të cilën pagesë debitori e ka realizuar, por që faturat e bashkëngjitura si në propozim nuk i ka pranuar asnjëherë dhe nuk e ka ditur se ekzistojnë. Ka shtuar se në këto fatura nuk ka asnjë dëshmi se janë pranuar nga debitori dhe nuk kanë as vullë dhe nënshkrim, ashtu që të njëjtat nuk mund të klasifikohen si dokument i besueshëm. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar dhe të anulohet urdhri për përmbartim.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit dhe ka deklaruar se qëllimi i vetëm i saj është prolongimi dhe shtyrja e përmbartimit. Tutje ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit rreth mosekzistimit të këtyre faturave, për shkak se të njëjtat i janë paraqitur debitorit, por i ka refuzuar, ashtu që nga kjo vërtetohet se shërbimi i faturuar është marrë nga debitori. Ka theksuar se debitori në asnjë rast nuk ka mohuar ekzistimin e kontratës së lidhur me kreditorin për qiramarrjen e lokalit afarist, e që vetë kjo kontratë si e tillë dëshmon që janë shfrytëzuar benefitet nga debitori duke e bërë të realizueshme kërkesën e debitorit sipas shumave të përcaktuara nga faturat e lartcekura. I ka propozuar gjykatës që ta hedhë poshtë si të pabazuar urdhrin e përmbartuesit privat dhe të obligohet debitori që t'i paguaj shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Faturën Nr. 47 të datës 05.08.2022; Faturën Nr. 88A të datës 01.10.2022 dhe Faturën Nr. 106 të datës 22.11.2022, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbardim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbardimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - faturat në bazë të së cilave është lejuar propozimi për përmbardim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se këto fatura në rastin konkret janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk janë pranuar nga debitori, përkatësisht të njëjtat nuk përmbajnë nënshkrimin e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se janë pranuar nga debitori në çfarëdo forme. Andaj duke qenë së debitori nuk i ka pranuar në mënyrë të rregullt faturat, të njëjtat nuk mund të shërbejnë si dokument i besueshëm.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të kreditorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbardimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbardimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbardimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbardim, e mbi bazën e të cilit Përmbarduesi Privat ka lejuar përmbardimin, nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshëm pasi që nuk kanë tipare të përmbardueshmërisë.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbardimore si dhe nenit 13

par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.130/24, datë 28.06.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.